



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/105
Datë: 18.01.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 18 janar 2010, mori

V E N D I M

1. Miratohet rekomandimi i propozuar nga Komiteti Drejtues Ndërministror për ndërtimin e Autostradës Vërmicë - Prishtinë - Merdare.
2. Qeveria e Republikës së Kosovës aprovon Ofertën alternative të trasesë së Autostradës Vërmicë - Prishtinë - Merdare.
3. Qeveria e Republikës së Kosovës miraton fillimin e negociatave me Kompaninë e parë ranguese Ofertuesi Bechtel - Enka Joint Venture për nënshkrimin e kontratës.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THACI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/105
Datë: 18.01.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 18 janar 2010, mori

V E N D I M

1. Komisioni Drejtues Ndërministror i emëruar me Vendimin e Qeverisë Nr. 02/15, të datës 10.04.2008, si dhe i emëruar të vazhdoj punën për të mbikëqyr zbatimin e projektit të Autostradës Vërmicë - Prishtinë - Merdare vendimi me nr. 04/59, datë: 27.03.2009, me anë të këtij vendimi caktohet zyrtarisht ta përfaqësoj Republikën e Kosovës si Autoritet Kontraktues në Numrin e prokurimit 09/103/514 për ndërtimin e Autostradës Vërmicë - Prishtinë - Merdare.
2. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë